



**SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
KOSOVË**

FTESE PER OFERTE

Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetarë.

SOS Fshatrat e Fëmijëve fton ofertuesit e specializuar dhe të interesuara për: **Ofertë për Sallë**, për realizimin e trajnimeve, seminareve, konferencave, dhe takimeve në kuadër të aktiviteteve të të gjithë projekteve si dhe të projektit YEEP2. Salla do të përdoret për të përmbushur aktivitetet e planifikuara gjatë vitit që do të ofrojnë mundësi për zhvillim profesional të punonjësve, shkëmbimin e përvojave me partnerë dhe bashkëpunëtorë, zgjerimin e partneriteteve dhe promovimin e punës së organizatës.

Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për Ofertë sipas specifikacionit në vijim:

Sallë Trajnimi

- Salla e cila ka kapacitet për përafërsisht 20-30 persona
- Salla të jetë e përshtatshme për punë në grupe, session plenar apo formate tjera
- Salla të ketë kushte për punë sa i përket ndriçimit, ajrosjes, pastërtisë dhe qetësisë;
- Ofrimi I ujit (2 shishe të vogla) për pjesëmarrës gjatë trajnimit
- Ofrimi I kafes (2 kafe) për pjesëmarrës gjatë pauzave
- Dreka për pjesëmarrës: Supë, sallatë, pjata kryesore, desert dhe një shishe e vogël ujë.

Salla duhet të jetë e pajisur me:

- Internet të shpejtë;
- Projektor;
- Tabelë për mbajtjen e letrave (flipchart)
- Mundësi për printim (e preferuar)

Salla duhet të jetë me lokacion në Prishtinë dhe jo më larg se 10 km nga qendra e Prishtinës

Dokumentet e nevojshme:

1. Qertifikata e regjistrimit të biznesit/ NUI
2. Qmimet e kuotuara në euro pa tvsh
3. Oferta financiare e ndarë me cmime për njësi: sallë, ujë, kafe dhe drekë
4. Oferta financiare e nënshkruar ose me llogo zyrtare

Kriteret për përzgjedhjen e ofertës më të mirë do të jenë si në vijim:

1. Përbushja e specifikacionit sipas Ftesës për Ofertë
2. Pas plotësimit të kriterëve - Çmimi më i lirë

Vlefshmëria e Ofertës duhet të jetë 30 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë.

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë Vërtetimin Tatimor

Ofertuesit e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet dhe ofertën e mbyllur në pliko/ zarf (2 kopje) të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor dhe të shënuar: **“Sallë për trajnime”**.

Ofertat duhet të dorëzohen deri me datën: **15.02.2024** në zyret e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, në adresën Velani “1 Tetori” p.n. Prishtinë cdo ditë pune nga ora 09:00-15:00